



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Prill 2021

Nr: 11

UDHËZIM

**PËR ZBATIMIN E MASAVE ANTI-COVID 19 GJATË DITËS SË VOTIMEVE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “b”, “dh” e “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në zbatim të Protokollit “Lidhur me masat anti-Covid 19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditës së votimeve”, të Institutit të Shëndetit Publik, datë 13.04.2021

UDHËZOJ:

1. Të merren masa të menjëhershme për zbatimin e Protokollit “Lidhur me masat anti-covid 19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditës së votimeve”, të Institutit të Shëndetit Publik, datë 13.04.2021, i cili i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Anëtarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor (KZAZ), të qendrave të votimit (QV) dhe të vendeve të numërimit të votave (VNV) dhe operatorët e caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të ndjekin me rigorozitet zbatimin e protokollit.
3. Anëtarët e KZAZ-ve, QV-ve e VNV-ve, dhe operatorët e caktuar nga KQZ-ja duhet të deklarojnë se nuk kanë temperaturë ose shqetësime të tjera të lidhura me shenjat e covid-19, duke plotësuar formularin e vetëdeklarimit të përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar dorëzohet në momentin që anëtari/operatori paraqitet në detyrë.
4. Vëzhguesit duhet të tregojnë para komisioneve formularin e vetëdeklarimit, referuar pikës 3 të këtij udhëzimi, për të cilin mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve, ku

evidentohet emri e mbiemri i vëzhguesit dhe përkatësia (subjekti zgjedhor, OJF shqiptare ose e huaj, organizatë ndërkombëtare etj.). Vëzhguesi pasi lexon shënimin e bërë nga administrata zgjedhore përkatëse në librin e protokollit të mbledhjeve, e nënshkruan atë.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Ngarkohen anëtarët e komisioneve zgjedhore, operatorët e caktuar nga KQZ-ja dhe vëzhguesit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Shtojca 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI NË KUADËR TË MASAVE ANTI COVID-19

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të _____,
(emër mbiemër)

nr. _____ /operatorit të caktuar nga KQZ-ja në QV nr. _____ /vëzhguesit të _____, deklaroj

(subjekti zgjedhor/organizata/OJF etj.)

se nuk kam temperaturë ose shqetësime të tjera të lidhura me shenjat e Covid-19.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë.

Data e deklaramit 25.4.2021

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

